



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 16 Mars 2018

Njoftim

Kuotat e barnatoreve dhe sigurimi i barnave me recetë që i mbulon FSSHM



Fondi për sigurim shëndetësor për vitin 2018 për barnat që jepen me recetë në kuadër Fondit, ka paraparë buxhet vjetor në vlerë prej 2,85 miliardë denarë, i cili dallon për 100 milion denarë më shumë se në vitin 2017. Në këtë buxhet janë të parapara edhe barnat e shtrenjta, si dhe barnat që përshkruhen nga mjekët gjatë shërbimeve të kujdestarisë të cilat jepen jashta kuotave të barnatoreve. Buxhetin vjetor për barna Fondi e përcakton në bazë të realizueshmërisë së kuotave, rritjes së përshkrimit të barnave nga ana e mjekëve dhe konsumit të barnave, gjithnjë në pajtueshmëri me mjetet që janë në dispozicion.

Fondi vazhdimisht e ndjek realizueshmërinë e kuotave të barnatoreve dhe sipas nevojës, reagon në korniza të mundësive. Barnatoret kanë mundësi t'a tejkalojnë kuotën mujore më së shumti deri 10% në muaj dhe të kryejnë harmonizim të kuotës gjashtë-mujore edhe atë dy herë në vit, në muajin Mars dhe Shtator.

Të dhënat e Fondit tregojnë se konsumi i barnave me recetë nëpër barnatore shënon rritje, gjë që e ndjek trendin bashkohor të konsumit dhe kjo vërehet përmes rrijës së sasisë të barnave prej vitit 2008 e deri më tani, që është pothuajse dyfishi i vlerës së përgjithshme të mjeteve që i ndan Fondi për barnat me recetë.

Tabela nr.1 Përshkrimi i numrit të recetave të realizuara dhe vlera financiare e tyre (të shprehura në denarë) për periudhën kohore 2008 - 2017

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Numri i recetave të realizuara në barnatore	10.29	14.97	15.28	16.33	17.49	17.82	19.39	21.13	22.27	23,09
Dallimi nga viti i kaluar (%)		45%	2%	7%	7%	2%	9%	9%	5%	4%



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Vlera totale e faturuar nga barnatoret (miliard denarë)	1,319	1,829	1,778	1,902	1,993	2,124	2,263	2,425	2,626	2,786
Dallimi nga viti i kaluar (%)		39%	-3%	7%	5%	7%	7%	7%	8%	6%

Për t'i furnizuar mjaftueshëm pacientët me barna me recetë nga kujdesi shëndetësor parësot, ndikojnë më shumë faktorë edhe atë: shpërndarja efikase e barnatoreve edhe nëpër vendbanimet rurale; shpërndarja e mjeteve financiare që në fakt njihen si kuota të barnatoreve; mundësia për dhënien e barnave të shtrenjtja jashta kuotave; zbatimi i metodologjisë krahasuese për përcaktimin e çmimeve referente të barnave nga lista pozitive, me anë të cilës kemi ulur shumë çmime të barnave; shprehija e mjekëve për përshkrimin e barnave; si dhe struktura dhe nevojat e banorëve.

Nëse një bar i përcaktuar për të cilin ka nevojë pacienti, nuk është në një barnatore shkak i harxhimit së kuotës, të nejtin pacienti ka të drejtë t'a marrë prej barnatores tjetër e cila akoma nuk e ka të realizuar kuotën e përcaktuar nga Fondi. Realizueshmëria e kuotave në nivel republikan në pesë muajt e fundit (Tetor 2017 – Shkurt 2018) është 103%, respektivisht rritja komulative është 15%, që do të thotë se kuotat e planifikuara për muajin Mars shënojnë ulje për 15%. Ky rezultat është edhe si pasojë e nivelit të ndotur të ajrit, sezonës së gripit dhe ftohjes, sëmundjeve kronike, faktorë këto që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e konsumit të barnave me recetë që i mbulon Fondi.

Tabela nr.2 Përshkrimi i kuotave të realizuara në periudhën mujore Tetor 2017 – Shkurt 2018

Tetor 2017	Nëntor 2017	Dhjetor 2017	Janar 2018	Shkurt* 2018 (projektim)	Tejkalimi i kuotës për 5 muaj	Projektim i kuotës Mars 2018
103%	103%	104%	102%	103%	15%	85%

Fondi ndërmerr masa urgjente, afatshkurte dhe afatgjate për t'ju siguruar barna me recetë të siguruarve.

Masa urgjente:

- ✓ Rritja e kuotës në muajin Mars në vlerë prej 15 milion denarë, të cilat do të shpërndahen në mënyrë lineare nëpër barnatoret.

Masa afatshkurte:



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



- ✓ Injekcion financiar buxhetit të përgjithshëm që dedikohet për barnat për vitin 2018, në vlerë prej 100 milion denarë në vit
- ✓ Revidimi i Rregullores dhe metodologjisë për shpërndarjen e mjeteve financiare – kuotave dhe kompenzimeve të barnatoreve
- ✓ Ndryshimin e muajit/terminit për të harmonizuar kuotat në periudhë (muaj) më të përshtatshme të vitit
- ✓ Mënyrë të re më të drejtë dhe më efikase për shpërndarjen e mjeteve nëpër barnatore
- ✓ Sistem më efikas për kompenzet e barnatoreve

Masat afatgjate:

- ✓ Rrishikimi i mundësive për futjen e sistemit elektronik të integruar dhe efikas përmes kyçjes së të gjitha institucioneve, institucioneve shëndetësore dhe të punësuarve mjekësor nga sistemi ynë, respektivisht futjen e regjistrimit elektronik shëndetësor për çdo pacient (*EHR- electronic health record*).

Disponueshmëria e barnave cilësore për të siguruarit e Maqedonisë, është angazhim i vazhdueshëm i Fondit për sigurim shëndetësor.